



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FACULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PSIKOLINGUISTIKË

Titullari /pedagogu i lëndës: Prof. Asoc. Dr. Etleva Kondi

Ngarkesa: 4 Kredite - (= 40 orë mësimore); *Leksione:* 1.5 Kredite - (= 15 orë mësimore);

Seminare: 2.5 Kredite - (= 25 orë);

Viti akademik: 2023-2024

Semestri kur zhvillohet: Viti i I, semestri 1

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, Mësuesi e Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Lartë

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: etleva.kondi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky kurs është një hyrje në fushën e psikolinguistikës dhe studion proceset psikologjike në bazë të mësimin, prodhimit dhe kuptimit të gjuhës.

Kursi përqëndrohet në mekanizmat psikologjikë të përdorur për përfitim të gjuhës. Ekziston një mendim i gabuar se në kursin e psikolinguistikës njihemi me karakteristikat e veçanta të gjuhëve; për shembull, se si për rasat gjuha shqipe përdor mbareta të ndryshme nga rusishtja. Por tërësisht e kundërta ndodh, ky kurs mëson ngjashmëritë që përshkojnë gjuhët që fliten në mbarë botën dhe pikërisht këto ngjashmëri do të na ndihmojnë të kuptojmë natyrën e aftësisë së prodhimit të gjuhës.

Në këtë kurs trajtohen çështje si lidhja e gjuhës me mendimin dhe kujtesën, lidhja e kulturës me gjuhën, përvetësimi i fjalive, kuptimi i saj dhe trajtimi i dykuptimësisë.

Gjithashtu, bilingualizmi dhe përvetësimi i gjuhës së huaj, leximi, shkrimi dhe mënyrat e trajtimit të problemeve të ndryshme që ndeshen gjatë mësimin të gjuhës së huaj janë pjesë e rëndësishme të kursit.

Ky kurs synon që studentët:

- të kuptojnë se si njohuritë gjuhësore organizohen dhe përpunohen nga mendja e njeriut.
- të zhvillojnë njohuri të mira mbi disiplinat e tjera që përfshin psikolinguistika si: bazat biologjike të gjuhës (gjuha dhe truri), perceptimi i të folurës, leksiku, përvetësimi i fjalisë, ligjërimi, prodhimi dhe përfitimi i gjuhës.
- të kuptojnë të dhënat nga perceptimi dhe prodhimi i gjuhës dhe se si këto të dhëna kanë ndihmuar në zhvillimin e teorive kryesore të psikolinguistikës.
- të fitohet një kuptim më i thellë i proceseve psikologjike që ndihmojnë në përfitim të gjuhës së huaj.

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë:

- të njohin dhe analizojnë çështjet kryesore lidhur me perceptimin e të folurit, njohjen leksikore, ndarjen e fjalive dhe të tekstit në pjesë si dhe përvetësimin e gjuhës dhe aftësive të leximit.
- të përshkruajnë dhe shpjegojnë çështjet më të rëndësishme të lidhjes së trurit me gjuhën dhe se si gjuha përftohet, përpunohet dhe ruhet.
- të kuptojnë lidhjen midis gjuhësisë së zbatuar, përfimit të gjuhës së huaj dhe psikolinguistikës.
- të fitojnë aftësinë për të studiuar gjuhësinë e zbatuar dhe gjuhën e huaj nga një këndvështrim psikolinguistik.

